



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË  
MËSUESVE TË LËNDËS “TIK”**

**SHKURT, 2023**

**Koordinator**

**Eriksen Mersinllari**

## TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE.....	3
II. QËLLIMI I PROGRAMIT .....	3
III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT .....	4
3.1 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit.....	5
3.1.1 <i>Fushat kryesore të zhvillimit profesional</i> .....	5
3.1.2 <i>Modele të testeve për secilin nivel arsimor AMU dhe AML</i> .....	11
3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit31	
3.2.1 <i>Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML</i> .....	31
3.2.2 <i>Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur</i> .....	41

## I. HYRJE

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Një mësuesi, për të qenë i aftë në punën e tij, nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësit, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore. Mësuesit punojnë me përgjegjshmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, zhvillojnë dhe përditësojnë njohuritë nëpërmjet vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve të vazhdueshme, ndërtojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe bashkëpunojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së TIK-ut është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së TIK-ut në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit, si dhe për përgatitjen e orës së hapur mësimore për marrjen e kategorisë së parë të kualifikimit,
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen.

## II. SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT

Synimet e hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi janë:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së TIK-ut në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar dhe të unifikuar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

### ***Programi ka për qëllim që mësuesi:***

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet globale që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndergjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar;
- të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

### **III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

#### **Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në dy pjesë:**

3.1 *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë (Mësues specialist) dhe të tretë (Mësues i kualifikuar) të kualifikimit. Në këtë rubrikë përfshihen, përveç kompetencave profesionale dhe rezultateve të pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, edhe dy modele testesh për lëndën e TIK-ut në secilin nivel arsimor: *arsim i mesëm i ulët (AMU)* dhe *arsim i mesëm i lartë (AML)*.*

3.2 *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë (Mësues mjeshtrë) të kualifikimit. Në këtë rubrikë ka dy modele orësh mësimore për lëndën e TIK-ut në secilin nivel arsimor: AMU dhe AML, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.*

### **3.1 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit**

Programi për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit përmban fushat kryesore të zhvillimit profesional, si dhe modele testesh për AMU dhe AML.

#### **3.1.1 Fushat kryesore të zhvillimit profesional**

Ky program është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve të kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë janë:

- dokumentacioni zyrtar<sup>1</sup> shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve në shkollë;
- programe lëndore të TIK-ut;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënies - nxënies të lëndës së TIK-ut;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të TIK-ut.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqëndrohet.

<b>FUSHA “DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR”</b>	
<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>

<sup>1</sup> Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqëndruar në ato të viteve të fundit.

<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i TIK-ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li> <li>• demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies;</li> <li>• zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>• respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>• respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>• zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020</li> <li>• Udhëzimi nr.22 “Për fillimin e vitit shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (27.07 2022).</li> <li>• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, date 28.7.2021</li> <li>• Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul>
--	---

FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË TIK-ut”	
Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të TIK-ut në shkollë”	Literatura e rekomanduar
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i TIK-ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza kurrikulare, 2014.</li> <li>• Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;</li> <li>• përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;</li> <li>• harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me njohuritë dhe shkathhtësitë e programit;</li> <li>• kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit;</li> <li>• tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të TIK-ut);</li> <li>• përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit;</li> <li>• siguron informacion që demonstroi lidhjen e TIK-ut me shkencat e tjera dhe me jetën reale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016.</li> <li>• Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.</li> </ul>
---	---

**FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”**

<p align="center"><b>Kompetenca I</b></p> <p align="center"><b>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e TIK-ut”</b></p>	<p align="center"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i TIK-ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;</li> <li>• demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;</li> <li>• identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar);</li> <li>• planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;</li> <li>• demonstroi qëndrim pozitiv ndaj lëndës së TIK-ut;</li> <li>• edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërkshërinë ndaj lëndës së TIK-ut;</li> <li>• motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;</li> <li>• krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>• punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.</li> </ul>
<p><b>Kompetenca II</b>  <b>“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e TIK-ut”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b>  <i>Mësuesi i TIK-ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objekti të caktuar;</li> <li>• përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;</li> <li>• planifikoi një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;</li> <li>• përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;</li> <li>• përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA (sot ASCAP) 2016.</li> <li>• Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018.</li> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.</li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor aplikimet teknologjike në mësimdhënien – nxënien e lëndës së TIK-ut;</li> <li>• demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;</li> <li>• shpjegon parimet e hartimit të një testi për nxënësit.</li> </ul>	
<b>Kompetenca III</b> <b>“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i TIK-ut:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• prezanton materiale duke përdorur software të ndryshëm aplikativë;</li> <li>• nxit nxënësit të bëjnë prezantime në TIK duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;</li> <li>• gjen dhe përdor materiale nga website të sigurta dhe të besueshme për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien;</li> <li>• përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së TIK-ut apo në projekte kurrikulare të integruara, të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga interneti.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së TIK-ut që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.</li> <li>• Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021.</li> <li>• Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021.</li> <li>• Literaturë që ka për fokus kryesor përdorimin e programeve kompjuterike.</li> </ul>

<b>FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”</b>	
<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</b>	<b>Literatura</b>
<b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i TIK-ut:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>njuh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020</li> <li>Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”</li> </ul>
--	--

### FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”

Kompetenca	Literatura
<p><b>“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</b></p>	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i TIK-ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>njuh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;</li> <li>demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>

### FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p><b>“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së TIK-ut”</b></p>	
<p><i>Mësuesi i TIK-ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e TIK-ut në klasat VI-IX dhe X-XII;</li> <li>përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve të TIK-ut në klasat VI-IX dhe X-XII;</li> <li>përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehjeve;</li> <li>dallon ndërvarësinë e koncepteve të TIK-ut nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Programe dhe tekste të lëndës së TIK-ut për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• zgjidh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme ushtrime, situata në TIK, të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve në klasat VI-IX dhe X-XII;</li> <li>• përdor informacion të saktë e bindës për vlerat përdoruese të TIK-ut në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme.</li> </ul>	
---	--

### 3.1.2 Modele të testeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML

#### TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI (TIK) ARSIMI I MESËM I ULËT

##### DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR

1. Bazuar në Udhëzimin për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve, provimi quhet i kryer me sukses nëse kandidati ka fituar të paktën: **1 pikë**
  - A) 30% të pikëve për secilën pjesë të testit.
  - B) 40% të pikëve për secilën pjesë të testit.
  - C) 50% të pikëve për pjesën e parë të testit.
  - D) 70% të pikëve për pjesën e parë të testit.
  
2. Një mësues i interesuar për të kuptuar se sa e përmbush standardin “Vlerësimi i të nxënit”, si një ndër standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit në arsimin parauniversitar, analizoi të gjithë treguesit e këtij standardi. Nga vlerësimi i treguesve të standardit i rezultoi që mesatarja e tij e pikëve për këtë standard ishte 2,8. Përcaktoni cilit nivel të arritjeve të standardeve të formimit të përgjithshëm të mësuesve i korrespondon kjo mesatare e pikëve: **1 pikë**
  - A) Nivelit 1
  - B) Nivelit 2
  - C) Nivelit 3
  - D) Nivelit 4

3. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G).

- a) Referuar Udhëzimit “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, punonjësit arsimorë trajnohen të paktën tre ditë në vit. Tre ditë trajnimi pasqyrojnë tre kredite. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) Referuar Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, në fillim të vitit shkollor, mësuesi dorëzon në drejtorinë e shkollës planin vjetor të lëndës, si edhe planin e periudhës së parë. Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë. Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar të periudhës, ndryshime të cilat miratohen nga drejtori i institucionit arsimor. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

### PROGRAMI LËNDOR

4. Cilat nga tematikat e mëposhtme nuk i përket shkallës së tretë të programit të lëndës së TIK-ut? **1 pikë**

- A) përpunimi digjital i tekstit dhe analiza e të dhënave.  
B) hyrje në programim.  
C) kërkimi në web/internet dhe e-mail-i.  
D) botimet dhe siguria në internet.

5. Plotësoni pohimin e mëposhtëm. **2 pikë**

Programi i TIK-ut për klasën e 8-të zhvillohet në 35 orë mësimore vjetore, prej të cilave \_\_\_\_\_ orë njohuri të reja dhe \_\_\_\_\_ përpunim njohurish.

6. Jepen më poshtë rezultatet e të nxëniet për tematikën “Hyrje në Programim dhe Excel-i”, Cilat **kompetenca lëndore** zhvillojnë dhe matin këto rezultate? **3 pikë**

- a) Nxënësi përdor kompjuterin për të zhvilluar të menduarit kreativ dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin. \_\_\_\_\_
- b) Nxënësi përcakton strategjinë e kërkimit të informacionit; duke përdorur kompjuterin gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave.
- \_\_\_\_\_

- c) Nxënësi vlerëson sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre në termat e mbledhjes së kërkesave, të rejave dhe qëndrueshmërisë. \_\_\_\_\_

### ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

7. Arta është një mësuese e re. Ajo është e shqetësuar, pasi vëren se nxënësit nuk janë shumë të qartë nga mësimdhënia e saj. Cila nga veprimtaritë e mëposhtme do t'i sigurojë asaj të dhënat për të bërë një analizë të qartë të dobësive që paraqesin nxënësit në lëndën e saj?

**1 pikë**

- A) Diskutimi me prindërit e nxënësve.
- B) Diskutimi me kolegët e së njëjtës lëndë.
- C) Diskutimi me nxënësit për të kuptuar dobësitë që ato kanë.
- D) Rezultatet e testimit të nxënësve.

8. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është karakteristike e një klase në të cilën ka një klimë pozitive?

**1 pikë**

- A) Rregulla të vendosura dhe inkurajimi i nxënësve në kryerjen e detyrave.
- B) Në klasë përdoret më shumë monologu se dialogu.
- C) Puna në grup dhe përfshirja e të gjithë nxënësve në mësim.
- D) Nxënësit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimtaritë.

9. Mësuesi zotëron njohuri dhe aftësi për integrimin e TIK-ut në përmbajtjen e lëndës në funksion të zhvillimit të kompetencave kyç dhe kompetencave lëndore, një aspekt shumë i rëndësishëm është edhe vlerësimi i nxënësve, për këtë arsye listoni disa platforma apo software aplikative, të cilat ndihmojnë mësuesin të realizojë vlerësimin e nxënësit.

**2 pikë**

---

---

---

---

---

---

10. Renditni dy nga llojet e pyetjeve që përdoren gjatë vlerësimit me test përmbledhës të nxënësve.

2 pikë

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

11. Janë dhënë më poshtë rezultatet e të nxënit të temës mësimore “Sistemi i programimit Visual Basic”

*Nxënësi:*

- Dallon sistemet e programimit për komunikimin me kompjuterin.
- Kupton disa terma të rëndësishëm në programin VB.
- Ndjek radhën e procedurave në VB.

Hartoni 3 nivelet e arritjes për vlerësimin e nxënësit për përmbushjen e këtyre rezultateve. 3 pikë

---

---

---

---

---

12. Hulumtimi, si një nga teknikat më të rëndësishme në realizimin e projekteve kurrikulare, kalon në disa etapa. Përcaktoni katër etapat e hulumtimit:

4 pikë

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

4. \_\_\_\_\_

## ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

**13.** Një klasë gjithëpërfshirëse është ajo ku: **1 pikë**

- A) vlerësimet përsëriten derisa çdo nxënës të arrijë rezultatet minimale.
- B) mësuesit japin mësim duke iu referuar vetëm tekstit mësimor për të pakësuar ngarkesën e nxënësve.
- C) ka një përfshirje aktive të nxënësve me rezultate të larta.
- D) mësuesit krijojnë për çdo nxënës praktika dhe përvoja të ndryshme të nxëni.

**14.** Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G).

Në Kodin e etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar, janë të përcaktuara detyrat që kanë të gjitha institucionet arsimore të arsimit parauniversitar për zbatimin e këtij Kodi.

a) Është detyrë e institucionit arsimor të përkthejë kodin e etikës në udhëzime, rregullore, etj. për sjelljet që duhen krijuar e mbështetur, në kushtet e veçanta të mjedisit të tij arsimor.

V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) Është detyrë e institucioneve arsimore të trajtojnë të gjithë prindërit dhe përfaqësuesit e pushtetit lokal për parimet dhe qëllimin e kodit të etikës.

V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

## ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

**15.** Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**

- A) Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë
- B) parlamenti i nxënësve të shqipërisë
- C) parlamenti i nxënësve të Shqipërisë
- D) Parlamenti i nxënësve të Shqipërisë

**16.** Nënvizoni fjalën që është shkruar gabim në fjalitë e mëposhtme. **3 pikë**

- a) Ne duhet t'i kushtojmë vëmëndje të veçantë problemit të braktisjes së shkollës për të gjetur arsytet e vërteta dhe për t'i dhënë zgjidhje.
- b) Kur nxënësi i klasave IV-IX mungon më shumë se pesë dhjetë për qind të orëve totale vjetore të planit mësimor, mbetet në klasë dhe përsërit vitin shkollor.

- c) Arsimi bazë synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes, kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës.

## PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

17. Në programin Scratch, grupi i instruksioneve Events përdoret për: **1 pikë**

- A) Të kontrolluar pamjen e skriptit
- B) Të kontrolluar lëvizjen e skriptit
- C) Të ekzekutuar fillimin e ngjarjes
- D) Të insertuar veprime matematikore

18. Të përcaktohet renditja e saktë e komponentëve të sistemit kompjuterik, mbështetur në shpejtësinë e transmetimit të të dhënave dhe duke filluar nga më e shpejta: **1 pikë**

- A) Cache, RAM, Hard Disk,
- B) Cache, Hard Disk, RAM
- C) RAM, Cache, Hard Disk
- D) Hard Disk, RAM, Cache

19. Si quhet sulmi keqdashës kur serveri mbingarkohet me kërkesa të shumta fiktive, të cilat si pasojë sjellin rënien e pajisjes? **1 pikë**

- A) Hashing
- B) Phishing
- C) Man in the middle
- D) Denial of Service

20. Bazuar në formulën e shënuar në qelizën E2, cila do të jetë vlera që do të përfitohet? **1 pikë**

	A	B	C	D	E	F
1						
2	2.5	1.6	5.2	7.4	=INT(SUM(A2:D2))	
3						




- A) 2.5
- B) 7.4
- C) 16
- D) 16.7

**21.** Në programin Microsoft Word, ndërmjet cilës menu mund të shtojmë ekuacione apo simbole matematikore në dokumentin që po punojmë? **1 pikë**

- A) Home
- B) Insert
- C) Data
- D) References

**22.** Duke ekzekutuar komandën e mëposhtme në programin Scratch, çfarë veprimi supozohet të kryej figurina (sprite), pasi përdoruesi klikon mbi flamurin e gjelbër? **1 pikë**

- A) Figurina lëviz horizontalisht majtas 50 njësi
- B) Figurina lëviz horizontalisht djathtas 50 njësi
- C) Figurina lëviz vertikalisht lartë 50 njësi
- D) Figurina lëviz vertikalisht poshtë 50 njësi



**23.** Cila nga komandat e mëposhtme përdoret për të bashkuar dy ose me shumë qeliza në Excel: **1 pikë**

- A) Filter
- B) Pivot
- C) Wrap
- D) Merge

**24.** Cili është veprimi i duhur për të insertuar një grafik në një prezantim PowerPoint: **1 pikë**

- A) Insert Menu>Pictures
- B) Insert Menu > Chart
- C) Insert Menu >Diagram
- D) Insert Menu >Graphics

25. Përzgjidhni alternativën e saktë:

1 pikë

- A) Mënyra më e mirë e lidhjes në Internet nga dy opsionet ADSL dhe Dial up, është ADSL sepse kemi transmetim më të shpejtë të të dhënave dhe nuk kemi ndërhyrje në linjën telefonike.
- B) Mënyra më e mirë e lidhjes në Internet nga dy opsionet ADSL dhe Dial up, është Dial up sepse kemi transmetim më të shpejtë të të dhënave dhe nuk kemi ndërhyrje në linjën telefonike.
- C) Mënyra më e mirë e lidhjes në Internet nga dy opsionet ADSL dhe Dial up, është Dial up sepse kemi shpejtësi interneti po thuajse të ngjashme me atë të Ethernetit
- D) Mënyra më e mirë e lidhjes në Internet nga dy opsionet ADSL dhe Dial up, është ADSL sepse kemi shpejtësi interneti po thuajse të ngjashme me atë të 4G

26. E vërtetë apo e gabuar?

3 pikë

- a) Në gjeneratën e dytë të zhvillimit të kompjuterave tranzistorët u zvendësuan me qarqet e integruara. V G
- b) Deny of service është kërcënimi i cili vjen si pasojë e pozicionimit të keqdashësit ndërmjet dy kompjuterave duke realizuar në këtë mënyrë gjurmimin e informacionit. V G
- c) Tranzistori është një pajisje gjysëm përçuese e cila shërben për transmetimin e sinjalit. V G

27. Shpjegoni ndryshimin midis referencave absolute dhe referencave relative në adresat e qelizave të programit Microsoft Excel?

2 pikë

---

---

---

28. Listoni hapat që duhen ndjekur për të siguruar një dokument në Word me një fjalëkalim të caktuar?

3 pikë

---

---

---

29. Lidh me shigjetë:

3 pikë

- A) TCP                    1. është protokoli i përdorur për transferimin e faqeve web në internet dhe shërben për komunikimin ndërmjet klientëve dhe serverave.
- B) HTTP                    2. përcakton se si paketat lëvizin nga njëra pajisje tek tjetra, apo se si renditen paketat e marra në destinacion sipas rendit të duhur të dërgimit.
- C) Telnet
- D) UDP                    3. është një protokoll klient-server, i bazuar në një transport të besueshëm i orientuar drejt lidhjes, i cili ofron aksesin në një kompjuter remote.

30. Hansi përgjatë fillimit të vitit të ri akademik është duke përgatitur plan buxhetin personal dhe për këtë arsye po përdor programin Microsoft Excel, papritur ajo vë re se në qelizën A2 shfaqet gabimi #####, në qelizën B1 shfaqet gabimi #DIV/0, kurse në qelizën E5 shfaqet gabimi #NAME? Çfarë veprimesh duhet të ndër marrë Hansi në mënyrë që të zgjidh problemet e mësipërme? 3 pikë

Gabimi ##### \_\_\_\_\_ 1 pikë

Gabimi #DIV/0 \_\_\_\_\_ 1 pikë

Gabimi #NAME? \_\_\_\_\_ 1 pikë

31. Plotëso vendet bosh: Freeware, Software, Shareware, Open-source

2 pikë

- a) \_\_\_\_\_ është një program(software) që është në dispozicion pa asnjë kosto dhe ka për qëllim të ndahet me të tjerët për të promovuar programin, por, është i kufizuar në një mënyrë apo një tjetër.

- b) \_\_\_\_\_ janë programe, kodi i të cilëve është i disponueshëm për modifikime dhe përmirësime nga çdo person. Programuesit të cilët kanë akses në kodin burim të një programi të caktuar mund ta përmirësojnë programin duke shtuar veçori të reja ose duke rregulluar pjesët e programit që nuk funksionojnë siç duhet.

**32. Listoni dy formate të ruajtjes së imazhit.**

**2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

**33. Çfarë janë driver-at? Listoni dy mënyra të instalimit të driver-ave në kompjuter?**

**3 pikë**

---

---

a) \_\_\_\_\_

**1 pikë**

b) \_\_\_\_\_

**1 pikë**

**34. Shpjegoni ndryshimin kryesor midis memories RAM dhe memories ROM?**

**2 pikë**

---

---

---

---

**35. Shpjegoni çfarë ekzekutojnë komandat e mëposhtëme në programin Microsoft Excel? 2 pikë**


a) *Sort Descending* \_\_\_\_\_

b) *Rename Sheet* \_\_\_\_\_

**36. Shkurani një program në Visual Basic, i cili të merr një numër si input nga përdoruesi dhe gjen vlerën kuadratike të këtij numri.**

**3 pikë**

37. Cila do të jetë vlera e variablit x dhe variablit y pas ekzekutimit të skriptit të mëposhtëm?  
Tregoni cilat janë grupet e instruksioneve kryesore të përdorura në programin e mëposhtëm  
(listoni 3 grupe instruksionesh). **3 pikë**



a) Vlera e variablit x: \_\_\_\_\_

b) Vlera e variablit y: \_\_\_\_\_

Grupet e blloqeve të instruksioneve të përdorura:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

**TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI (TIK)  
ARSIMI I MESËM I LARTË**

**DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR**

1. Bazuar në Udhëzimin për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve, kandidati ka të drejtë të ankohet me shkrim për parregullsitë gjatë zhvillimit të provimit ose për ndëshkimet që i janë dhënë nga administratori: **1 pikë**
  - A) brenda 2 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
  - B) brenda 3 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
  - C) brenda 4 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
  - D) brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
2. Vetëvlerësimi dhe analiza serioze, e detajuar dhe periodike e vetes mbi bazën e standardeve profesionale të formimit të përgjithshëm i jep mësuesit një mundësi të çmuar për të kuptuar në

kohë pikat e tij të forta dhe ato të dobëta. Nivelet e arritjeve përmes të cilave mësuesit mund të bëjnë vetëvlerësimin dhe të përcaktojnë arritjen e kompetencës së tyre profesionale janë:

**1 pikë**

- A) dy.
- B) tre.
- C) katër.
- D) pesë.

**3.** Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G).

- a) Komisioni i disiplinës në shkollë ngrihet në çdo fillim të vitit shkollor dhe kryesohet nga drejtori i institucionit arsimor. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) Komisioni i disiplinës në shkollë i merr vendimet me votim të hapur. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

### **PROGRAMI LËNDOR**

**4.** Nxënësit/et zhvillojnë aftësitë e tyre, kreativitetin dhe njohuritë në shkenca kompjuterike, mediat digjitale dhe të teknologjisë së informacionit. Këto aftësi zhvillohen në tematikën e fushës:

**1 pikë**

- A) Algoritmika dhe programimi
- B) Bota e kompjuterit (hardware, software).
- C) Përpunimi digjital i të dhënave
- D) Programimi në Web

**5.** Programi i TIK-ut për shkallën e VI, klasa e 12 të kurrikulës me zgjedhje zhvillohet 2 orë në javë. Listoni më poshtë 3 tematika që trajtohen në këtë shkallë.

**3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

**6.** Cilën *kompetencë lëndore* zhvillojnë dhe matin këto rezultate të nxëni?

**2 pikë**

- a) Nxënësit analizojnë burime informacioni elektronike, kritikojnë besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre \_\_\_\_\_.

**1 pikë**

- b) Nxënësit vlerësojnë rreziqet që lidhen me mjediset online dhe krijojnë strategji të përshtatshme të sigurisë dhe kodeve të sjelljes \_\_\_\_\_ . **1 pikë**

### **ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË**

- 7.** Cili nga pohimet e mëposhtëm nuk është i vërtetë në lidhje me testin/detyrën përmbledhëse: **1 pikë**

- A) Mësuesi duhet të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor testet ose detyrat përmbledhëse.
- B) Koha e realizimit të testit ose detyrës përmbledhëse është 45 minuta.
- C) Testi/detyra përmbledhëse domosdoshmërisht realizohet në fund të periudhës.
- D) Në momentin kur mësuesi vlerëson testet/detyrat përmbledhëse, i vendos notat në regjistër.

- 8.** Duke kontrolluar punën që po zhvillojnë nxënësit në klasë mësuesi vë re se njëri prej nxënësve e ka zgjidhur ushtrimin në mënyrë të gabuar. Hapi i parë që mësuesi duhet të ndërmarrë për të përmirësuar këtë mangësi është: **1 pikë**

- A) I jep ushtrime të ngjashme për detyrë shtëpie
- B) Bashkëbisedon me nxënësin dhe ndihmon për gjetjen e gabimit
- C) I thotë nxënësit ta zgjidhë edhe njëherë ushtrimin
- D) I tregon vetëm përgjigjen e saktë të ushtrimit

- 9.** Mësuesi zotëron njohuri dhe aftësi për integrimin e TIK-ut në përmbajtjen e lëndës në funksion të zhvillimit të kompetencave kyç dhe kompetencave lëndore, një aspekt shumë i rëndësishëm është edhe vlerësimi i nxënësve, për këtë arsye listoni disa platforma apo software aplikative, të cilat ndihmojnë mësuesin të realizojë vlerësimin e nxënësit. **3 pikë**
- 
- 
- 

- 10.** Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës sepse i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe i lirë në procesin e mësimit. Për një planifikim të mirë mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme: **3 pikë**
-

---

---

11. Në temën mësimore “Siguria e rrjetit dhe rëndësia e saj. Kriptografia”, rezultatet të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore janë: **3 pikë**

- vlerëson rëndësinë e sigurisë në rrjet;
- njih kërcënimet që vijnë nga rrjeti;
- njih proceset që garantojnë siguri në rrjet.

Hartoni 3 nivelet e arritjes për vlerësimin e nxënësit për përmbushjen e këtyre rezultateve:

---

---

---

12. Metodot, teknikat dhe strategjitë e të nxëniet në lëndën e TIK-ut janë faktorë të rëndësishëm për një nxënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësit. Metodot e mësimdhënies që kanë në qendër veprimtarinë e nxënësit, ndahen në tre nëngrupe. Listoni dy prej tyre. **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

### **ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS**

13. Cila nga thëniet e mëposhtme përshkruan më mirë “gjithëpërfshirjen”? **1 pikë**

- A) Është besimi se nxënësit duhet të veçohen sipas aftësive të tyre.
- B) Është besimi se disa nxënës nuk mund të mësojnë.
- C) Është filozofia që të gjithë nxënësit kanë të drejtë të marrin arsim të barabartë në një sistem arsimor.
- D) Është filozofia që nxënësit me nevoja të veçanta kanë nevojë për shkolla speciale.

14. Përcaktoni dy ndër parimet themelore mbi të cilat hartohet Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar: **2 pikë**



- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

## ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

1 pikë

- A) Këshilli Kombëtar i Prindërve
- B) këshilli kombëtar i prindërve
- C) Këshilli kombëtar i prindërve
- D) Këshilli Kombëtar i prindërve

16. Nënvizoni fjalën që është shkruar gabim në fjalitë e mëposhtme.

3 pikë

- a) Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të qendrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin e lartë ose për tregun e punës.
- b) Nxënësi deri në moshën njëzetë e dy vjeç lejohet të ndjekë arsimin e mesëm të lartë katërvjeçar.
- c) Veprimtaritë plotësuse dhe ato jashtëshkollore që zhvillohen në nivel institucioni arsimor, pasqyrohen në një dokument ku shënohet synimi i veprimtarisë dhe përshkruhet përmbledhtas ecuria e saj.

## PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

17. Në cilën prej alternativave të mëposhtme, të dyja opsionet bëjnë pjesë të strukturat jo lineare të të dhënave?

1 pikë

- A) Stivat dhe Radhët
- B) Pemët binare dhe Grafët
- C) Grafët dhe Vektorët
- D) Listat e lidhura dhe Pemët binare

18. Instruksioni që lejon ndryshimin e rregullt të fluksit të instruksioneve, i cili provokon daljen e menjëhershme nga cikli për të vazhduar me instruksionin që pason ciklin quhet:

1 pikë

- A) Instruksioni break
- B) Instruksioni continue
- C) Instruksioni switch
- D) Instruksioni for each

**19.** Kush është instruksioni i saktë që duhet ekzekutuar në SQL, për të selektuar të gjithë emrat që fillojnë me shkronjën “B” në kolonën Emri\_Studenti të tabelës STUDENT? **1 pikë**

- A) `SELECT * FROM STUDENT WHERE Emri_Studenti LIKE 'B%'`
- B) `SELECT * FROM STUDENT WHERE Emri_Studenti LIKE '%B'`
- C) `SELECT * FROM STUDENT WHERE Emri_Studenti ='B'`
- D) `SELECT * FROM STUDENT WHERE Emri_Studenti ='%B%'`

**20.** Qëllimi i atributit "alt" i një elementi "img" në HTML është të: **1 pikë**

- A) specifikoje tekstin që përdouesi duhet të klikojë për të shfaqur një imazh
- B) specifikoje tekstin që duhet të shfaqet kur mausi vendoset sipër një imazhi
- C) specifikoje vendodhjen e imazhit në internet
- D) specifikoje tekstin që duhet të shfaqet nëse imazhi nuk ngarkohet

**21.** Cili nga komponentët e mëposhtëm bën të mundur përkthimin e kodit burim në një kod ndërmjetës dhe interpreton këtë kod rresht pas rreshti? **1 pikë**

- A) Kompilatori
- B) Asembleri
- C) Interpretuesi
- D) Përpiluesi

**22.** Cili nga pohimet është i vërtetë për Rekursivitetin? **1 pikë**

- A) Është procesi i cili bën të mundur renditjen e elementëve në rend rritës në një funksion
- B) Është procesi i cili mat sasinë e kohës që i duhet një funksioni për t'u ekzekutuar
- C) Është procesi në të cilën një funksion thërret vetveten e tij në mënyrë direkte ose indirekte
- D) Është procesi i cili realizon radhën e kryerjes së veprimeve procedurale në ekzekutim

**23.** Cila pajisje lidh komponentë siç mund të jenë kompjuterat, printerat, skanerat dhe i bën ato të punojnë si një segment i vetëm në rrjetit: **1 pikë**

- A) Pajisja Switch
- B) Pajisja Hub
- C) Pajisja Router
- D) Pajisja NIC

**24.** Inline CSS përdor: **1 pikë**

- A) Atributin "style" brenda një elementi HTML
- B) Tagun <style> në header-in e një dokumenti HTML
- C) Tagun <css>në header-in e një dokumenti HTML
- D) Një skedar për të specifikuar aparencën e elementëve HTML

**25.** Çfarë do të afishohet në konsolë nëse ekzekutojmë kodin e mëposhtem në JavaScript: **1 pikë**

```
var vektori=[8, 10, 12];  
console.log(vektori[3]);
```

- A) 12
- B) 8 10 12
- C) undefined
- D) 12 12 12

**26.** Çfarë është tipologjia Bus? Listoni disa nga përparësitë dhe mangësitë e kësaj tipologjie rrjeti. Gjithashtu paraqisni në mënyrë skematike vendosjen e komponentëve kompjuterik.

**3 pikë**

---

---

---

---

---

---

27. Plotëso vëndet bosh: Algoritëm, Rekrusiviteti, Kompilim, Printf ()

2 pikë

- a) \_\_\_\_\_ është procesi në të cilin një funksion thërret veten e tij në mënyrë direkte apo indirekte.
- b) \_\_\_\_\_ është një sekuencë veprimesh që ka si qëllim zgjidhjen e një problemi të caktuar, duke shpjeguar rrugën dhe hapat që ndiqen për zgjidhjen e tij.

28. Çfarë janë applet-et?

1 pikë

---

---

---

29. Gebri është duke dizenuar një program shumë të rëndësishëm për kompaninë Alpha.shpk, e cila do të krijoj një sistem të brendshëm, ku të ketë të magazinuar të gjithë të dhënat e punonjësve të saj, përfshirë këtu bilancet dhe listëpagesat mujore. Gebri përgjatë zhvillimit të sistemit është duke hasur disa vështirësi lidhur me përdorimin e metodës POST dhe metodës GET për të dërguar të dhënat e kompanisë në webserver. Bazuar në situatën aktuale duke marrë në konsideratë të dhënat sensitive të firmës, cilën metodë do t'i rekomandonit Gebrit që të përdorte dhe pse?

2 pikë

---

---

---

30. E vërtetë apo e gabuar ?

3 pikë

- A) Firewall është një sistem sigurie rrjeti që monitoron dhe kontrollon trafikun e rrjeteve hyrëse dhe dalëse bazuar në rregulla të paracaktuara të sigurisë. V/G \_\_\_\_\_ 1 pikë
- B) Utility heq elemente të tepërta dhe të dhënat e panevojshme nga hapësira e ruajtjes së kompjuterit, kështu kërkohet më pak hapësirë për ruajtjen ose transmetimin e të dhënave. V/G \_\_\_\_\_ 1 pikë
- C) Sistemi i kompresimit lejon përdoruesin të kryejë detyra të mirëmbajtjes, që zakonisht lidhen me administrimin e kompjuterit ose pajisjeve të lidhura në rrjet. V/G \_\_\_\_\_ 1 pikë

**31.** Duke pasur parasysh rregullat dhe mekanizmat e sigurisë në sistemet kompjuterike, për secilin nga veprimet e mëposhtme përcaktoni nëse kemi të bëjmë me procesin, e identifikimit, autentifikimit apo autorizimit. **3 pikë**

1. Mësuese Albana vendos në regjistrin digjital notat e testimit përfundimtar \_\_\_\_\_
2. Mësuese Albana vendos kredencialet në sistemin SMIP \_\_\_\_\_
3. Mësuese Albana konfirmon kodin 6-shifror të ardhur në adresën e saj elektronike \_\_\_\_\_

**32.** Lidh me shigjetë: **3 pikë**

- |           |                                     |
|-----------|-------------------------------------|
| A) CREATE | 1. Data Manipulation Language (DML) |
| B) DELETE | 2. Data Definition Language (DDL)   |
| C) ALTER  | 3. Data Control Language (DCL)      |

**33.** Plotëso vendet bosh: Instruksionet e kontrollit, Instruksionet ciklike, Instruksionet input/output, Instruksionet operative , Instruksionet e kërcimit. **2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_verifikojnë kushtet e përcaktuara dhe, në bazë të rezultatit të gjeneruar, përcaktojnë fluksin e instruksioneve që duhet të ekzekutohet. **1 pikë**
- b) \_\_\_\_\_ndryshojnë fluksin normal të ekzekutimit sekuencial të instruksioneve të një algoritmi, duke specifikuar se cili është instruksioni i radhës që do të ekzekutohet **1 pikë**

**34.** Shkruani kodin në HTML për të shfaqur në browser, tabelën e mëposhtme: **3 pikë**

Nxënësi	Lënda		
	Gjuhë shqipe	Matematikë	Biologji
Klodian Hoxha	10	10	9
Viola Kurti	9	8	9

**35.** Ndërtoni pseudokodin dhe bllokskemën për një program i cili gjen perimetrin dhe sipërfaqen e një trekëndëshi kënddrejtë, kur janë dhënë të dy katetet nga përdoruesi. **3 pikë**

**36.** Në sekuencën e kodit të mëposhtëm plotësoni hapësirën bosh në mënyrë që të stilizoni me ngjyrë blu të gjithë paragrafët që përmbajnë id= “seksioni1” dhe vendosni llojin e shkrimit Helvetica për elementet e HTML që i përkasin klasës class=“intro”. **2 pikë**

```
<style>
```

```
</style>
```

```
<body>
```

```
<h1 class= “intro”>Veprat letrare</h1>
```

```
<p id= " seksioni1">Në këtë material maturantët mund të gjejnë të listuar veprat letrare dhe autorët e huaj e shqiptarë të cilët janë pjesë e programit orientues të Letërsisë në Maturën Shtetërore 2020-2021</p>
```

```
<p id= " seksioni1">Romani “I Huaji” u botua në vitin 1942. Ai është vlerësuar nga kritika si një ndër romanet franceze më të rëndësishme të shekullit të XX. Ky roman i dha impuls lindjes së letërsisë së absurdit të viteve 50-60.</p>
```

```
</body>
```

**37.** Ndërtoni një program në JavaScript, i cili llogarit shumën e dy numrave çift të vendosura nga përdoruesi. Programi duhet të kthejë rezultatin e shumës vetëm në rastin kur të dy numrat e

insertuar nga përdoruesi janë çift, në të kundërt me ndihmën e një alert-i do të afishohet një mesazh gabimi. (Referojuni figurave më poshtë)

**4 pikë**

This page says

Vendosni numrin e parë:

OK

Cancel

This page says

Vendosni numrin e dytë:

OK

Cancel

This page says

Shuma e numrave të vendosura nga përdoruesi = 14

OK

This page says

Kujdes numrat e insertuara nga përdoruesi nuk janë çift

OK

### ***3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit***

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenaduar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësve. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Programi orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit përmban model ore mësimore për AMU-në dhe për AML-n si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

#### **3.2.1 Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML**

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur për kategorinë e parë të kualifikimit, më poshtë është dhënë një model ore mësimore për secilin nivel arsimor: AMU dhe

AML. Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënësve, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.

### Model ore mësimore në lëndën e TIK-ut AMU

Fusha: TEKNOLOGJI DHE TIK	Lënda: TIK	Shkalla: 3	Klasa: VII																
<b>Tematika:</b> Përpunimi digjital i tekstit  <b>Tema mësimore:</b> Analiza e të dhënave dhe përdorimi i formulave në Excel .		<b>Situata e të nxënësve:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kujtoni veprimet e organizuara për një qelizë në Excel. Si do të veprojmë me veprime më të komplikuar?</li> <li>Duke marrë shkas nga njohuritë që keni marrë në lëndën e matematikës, gjeni notën mesatare të marrë në një grup prej 10 nxënësish , tabela e dendurive për të cilët është dhënë më poshtë:</li> </ul> <table border="1"> <tr> <td>nota</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>6</td> <td>7</td> <td>8</td> <td>9</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>denduria</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>2</td> </tr> </table> Si mendoni, a mund ta gjejmë këtë me anë të Excel-it?		nota	4	5	6	7	8	9	10	denduria	2	3	2	0	1	0	2
nota	4	5	6	7	8	9	10												
denduria	2	3	2	0	1	0	2												
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave digjitale sipas temës mësimore:</b> <i>Nxënësi:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>kopjon një formulë të thjeshtë të dhënë gati në tabelë;</li> <li>shkruan një formulë me jo më shumë se dy veprime;</li> <li>shkruan formulën më qëllim llogaritjen e përmbajtjes së saj;</li> <li>lexon gabimet që mund të dalin gjatë llogaritjes së qelizave në Excel;</li> <li>përshtat një situatë problemore në një tabelë të specifikuar për zgjidhjen e saj.</li> </ul>		<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:</b> <b>Kompetenca e të nxënësve:</b> Nxënësi përzgjedh me efikasitet të dhëna nga burime të ndryshme dhe i shfrytëzon për të arritur realizimin e temës mësimore; <b>Kompetenca e të menduarit:</b> Nxënësi organizon lidhjen konceptuale të njohurive; <b>Kompetenca personale:</b> Nxënësi demonstroi pavarësi në mendime e veprime; <b>Kompetenca qytetare:</b> Nxënësi përkushtohet ndaj rregullave të mirësjelljes dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave që i theyejnë ato.																	
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi; ...etj.		<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit; videoprojektor; laborator i TIK-	<b>Fjalët kyçe:</b> Qelizë, barazim, kllapa, enter, sum, average; radhë veprimesh; Microsoft Excel; Formulas;																



ut; laptop; tableta,  
etj.

Function, Auditing, Error  
Checking, etj.


## Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

### Organizimi i orës së mësimi:

#### **Faza 1:**

#### **Parashikimi i të nxënësve - diskutim për njohuritë paraprake + drejtim i imagjinatës – punë me klasën:**

Fillohet biseda duke i njohur nxënësit fillimisht me temën dhe drejtohet imagjinata e tyre në njohuritë e marra në klasën e gjashtë mbi mundësitë e shumta që na ofron përdorimi i programit Microsoft Excel. Këtu natyrisht përdoren pauza në bisedim të cilat u japin “ftesën” e pjesëmarrjes në diskutim. Në qos ata ngurojnë, artikulojnë me ngadalë veprimet matematikore, si psh: mbledhja, zbritja, shumëzimi, pjesëtimi etj, duke zgjuar kujtesën e tyre. Këtu mund t’u kërkojmë nxënësve të tregojnë në faqen e hapur të Excel-it, tek menuja “Home”, vendndodhjen e komandave, të cilat realizojnë kryerjen e veprimeve të ndryshme matematikore.




Jepet pjesa e dytë e përshkruar në situatë, një ushtrim matematikor i njohur prej tyre dhe pritet të realizojnë zgjidhjen. I japim formën përfundimtare bashkarisht këtij ushtrimi në tabelën e zezë.

$$(Nm = \frac{2x4 + 3x5 + 2x6 + 0x7 + 1x8 + 0x9}{10} = \frac{2x10}{10} \approx 6,3)$$

dhe më pas identifikojmë këtu “nevojën” apo mundësitë që na jep Excel-i.

#### **Faza 2:**

#### **Ndërtimi i njohurive të reja-vëzhgo- analizo-diskuto + kategorizimi i problemit - punë në grupe + punë me klasën :**



Drejtohet vëmendja e nxënësve në libër tek pjesa “llogaritja e formulës në një qelizë të dhënë” dhe “kopjimi i formulës”, ku shpjegimi mbështetet edhe në figurat shoqëruese të librit:

*Ritheksohet që:* Llogaritjet në Excel fillojnë gjithmonë me shenjën e barazimit (=).

Menjëhërë më pas, realizohen nga ana e mësuesit disa veprime të tilla duke u mbështetur në punën me videoprojektor. Sipas grupeve të formuara, nxënësit kopjojnë nga puna treguese që sapo panë, veprime të ngjashme. Nxënësit mbështeten në saktësinë e punës me njëri-tjetrin dhe pyeten nëse kanë nevojë për ndihmë nga mësuesi.

Pyeten nëq dinë ta shtrijnë këtë formulë në disa qeliza dhe sidoqofshin përgjigjet e tyre, realizohet përsëri më anë të videoprojektorit, kopjimi i kësaj formule për disa qeliza.

Gjithsesi, realizohet duke selektuar “qelizën rezultat” dhe duke e tërhequr “kursorin” e shfaqur në cepin e djathtë -poshtë të saj, deri në pozicionin e nevojshëm.

Këtu lihen pak të lirë të provojnë saktësinë e kësaj mënyre, psh duke plotësuar disa prej qelizave të mëposhtme të kollonave B, C e D.

Më pas, u kërkohet të realizojnë, secili prej grupeve, një llogaritje me dy veprime, njëri prej të cilëve të jetë shumëzim apo pjesëtim dhe tjetri mbledhje apo zbritje. Këtu gjejmë vend për të kujtuar radhën e veprimeve në shprehjet numerike në matematikë dhe ta paralelizojmë atë me veprimet që na mundëson Excel-i, duke përfshirë edhe kllapat.

Lexohet materiali në pjesën “Gabimet gjatë llogaritjes së një formule në Excel”.

Përsëri me mundësitë që ofron përdorimi i videoprojektorit, shpjegohet se te shiriti i menuve dhe komandave në Excel, ndodhet menuja “Formulas”, e cila është specifike vetëm për këtë program, ku mund të krijojmë formula dhe funksione për llogaritjen e të dhënave, si dhe të bëjmë korrigjimet e mundshme. Po kështu, mund të shohim edhe shfaqjen e mesazheve të gabimit dhe shkaqet e mundshme. Shfaqet për nxënësit tabela e mëposhtme për të treguar disa prej mesazheve të gabimeve që ndodhin më shpesh gjatë punës në Excel.

Mesazhet e gabimit	Shkaqet e mundshme
#####	Kolona nuk është e gjerë mjaftueshëm për të paraqitur rezultatin ose vlerën.
#DIV/0!	Është bërë pjesëtimi me zero, që është i palejueshëm në matematikë.
#N/A	Të dhënat janë të padisponueshme, psh mund të mungojnë nëpër qeliza. Apo qeliza mund të jetë bosh.
#VALUE!	Të dhënat janë të pavlefshme, psh mbledh një numër me një string.
#NAME!	Teksti nuk njihet nga programi.
#REF!	Referenca e qelizës është e pavlefshme.

### Faza 3:

#### ***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura - punë me klasën + praktikë e pavarur :***

Realizohet nga të gjithë pjesa “Ushtrohu” në libër dhe njëri prej nxënësve mund edhe ta demonstrojë atë për gjithë klasën, duke u diskutuar bashkarisht rezultati. Argumentohen veprimet dhe pyeten për ndjesitë e kësaj pune.

#### **Detyrat dhe puna e pavarur:**

Ndahet klasa në dy grupe dhe jepen dy detyra:

1. Grupit të parë i jepet si detyrë, që gjatë javës të realizojnë një studim blerjesh në familje duke hartuar më parë një tabelë përmbledhëse dhe duke zbatuar ato veprime që ata mendojnë apo kanë dëshirë t'i paraqesin. Materialin mund ta printojnë apo edhe ta dërgojnë më e-mail

U jepet si shembull tabela e mëposhtme dhe hapat në të sipas tre pamjeve:

### Hapi i parë:

Shpenzimet javore për disa artikuj në familjen time												
Ditët	bukë	lekë	ujë	lekë	perime	lekë	fruta	lekë	bulmet	lekë	totali (lekë)	
e hënë	1	120	2	220	3kg	580	5kg	870	4kg	230	=E8+G8+I8+K8+M8	
e martë												
e mërkurë												
e enjte												
e premte												
e shtunë												
e diel												
Totali javor												

### Hapi i dytë:




Shpenzimet javore për disa artikuj në familjen time											
Ditët	bukë	lekë	ujë	lekë	perime	lekë	fruta	lekë	bulmet	lekë	totali (lekë)
e hënë	1	120	2	220	3kg	580	5kg	870	4kg	230	2020
e martë											0
e mërkurë											0
e enjte											0
e premte											0
e shtunë											0
e diel											0
Totali javor											

### Hapi i tretë:

2. Grupit të dytë i jepet si detyrë që të realizojnë një studim formulash të disa figurave matematikor, duke hartuar më parë një tabelë përmbledhëse dhe më pas duke zbatuar ato veprime që u ka mësuar. Materialin mund ta printojnë apo edhe ta dërgojnë më pas me e-mail
- U jepet si shembull tabela e mëposhtme dhe hapat në të sipas pamjeve të mëposhtme:

### Hapi i parë:

	a	b	h	Syprina(cm <sup>2</sup> )
Katrori	2	2		=E7*F7
Drejtëndëshi				
Trapezi				
trekëndëshi				




### Hapi i dytë:

	a	b	h	Syprina(cm <sup>2</sup> )
Katrori	2	2		4
Drejtëndëshi	4	2		8
Trapezi	5	3,2	3,5	10,85
trekëndëshi	3		4	$=(E10*G10)/2$



a= 2 cm




a= 4 cm

b=2 cm



a=3 cm

h= 4 cm



b=3,2 cm

a=5 cm


h= 3,5 cm

### Hapi i tretë:

	a	b	h	Syprina(cm <sup>2</sup> )
Katrori	2	2		4
Drejtëndëshi	4	2		8
Trapezi	5	3,2	3,5	10,85
trekëndëshi	3		4	6
Syprina e figurës së përbërë				18



a= 2 cm




a= 4 cm

b=2 cm



a=3 cm


h= 4 cm



b=3,2 cm

a=5 cm

h= 3,5 cm



### Vlerësimi sipas niveleve:

- N2: nxënësi kopjon veprimin e kërkuar sipas formulës së përcaktuar me një veprim;  
 kryen kopjimin e formulës në një grup qelizash;
- N3: nxënësi dallon dhe përshkruan zbatimin e formulave me dy veprime sipas specifikimeve;  
 zgjidh kërkesa të ndryshme duke radhitur veprimet sipas rregullave të mësuara;
- N4: nxënësi argumenton gabimet që mund të dalin gjatë punës me formulat në Excel;  
 përshtat një situatë problemore sipas mësimit, duke u nisur që në planifikim, zbatim dhe deri në  
 specifikimin e saktë të zgjidhjes së saj.

## Model ore mësimore në lëndën e TIK-ut AML


<b>Fusha:</b> TEKNOLOGJI DHE TIK	<b>Lënda:</b> TIK	<b>Shkalla:</b> 5	<b>Klasa:</b> X
<b>Tematika:</b> Programimi në Web		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Tema mësimore:</b> HTML dhe CSS		Stilizimi i elementeve HTML ndërmjet përdorimit të gjuhës CSS në tri mënyra të ndryshme.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës mësimore:</b>			
<i>Nxënësi:</i>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ njeh rolin e përdorimit të gjuhës CSS në faqet e internetit (website)</li> <li>▪ identifikon mënyrat e inkorporimit të elementeve CSS në dokumentet HTML</li> <li>▪ aplikon njohuritë e marra në stilizimin praktik të elementeve HTML</li> </ul>			
<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, Mateamatikë, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi; ...etj.		<b>Burimet:</b> Libri i nxënësit; videoprojektor; laboratori i TIK-ut; laptop; tableta, program Notepad++	<b>Fjalët kyçe:</b> HyperText Markup Language (HTML), Cascading Style Sheets (CSS), sintaksë, stilizim, skedarë, paragrafë, imazh, link.
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Organizimi i orës së mësimimit:</b>			
<i>Parashikimi (Diskutim për njohuritë paraprake)</i>			
Mësuesi u drejton nxënësve pyetje të shkurtra që kanë lidhje me temën e mësimimit të ri:			
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Si mendoni ju se si realizohet stilizimi i faqeve të internetit?</li> <li>▪ Cilat janë elementet grafike që ju tërheqin më shumë vëmendjen kur jeni duke naviguar në një faqe interenti?</li> <li>▪ Sa të familjarizuar jeni ju me gjuhën CSS?</li> <li>▪ Cili mendoni se është roli i përdorimit të kësaj gjuhe në dokumentat HTML?</li> </ul>			
<i>Nxënësit japin përgjigjet e tyre lidhur me pyetjet e mësipërme. Ata komentojnë përgjigjet e shokëve/shoqeve dhe shtojnë ide të reja. Mendimet më të sakta mesuesi mund ti shkruajë në flipçart ose në dërrasën e zezë.</i>			
Pasi ka ftuar nxënësit në diskutim dhe ka marrë një feedback lidhur me njohuritë aktuale që nxënësit zotërojnë rreth gjuhës CSS, mësuesi shkruan në tabelë ose në flipchart <b>HTML + CSS</b> dhe nxit nxënësit të			

japin përgjigje lidhur me funksionin e përdorimit të këtyre gjuhëve duke marrë në konsideratë të përbashkta dhe dallimet që mund të kenë këto dy gjuhë.

HTML

CSS

Në përfundim të diskutimit paraprak me nxënësit, mësuesi paraqet në videoprojektor imazhin e mëposhtëm, i cili paralelizon përdorimin e gjuhës HTML dhe CSS me situatë nga jeta e përditshme, për të kuptuar më qartë arsyen e përdorimit të kodit CSS në dokumentat HTML.



### ***Ndërtimi i njohurive:***

Mësuesi shpjegon në terma teorik funksionimin e përdorimit të gjuhës CSS, së bashku me mënyrat e inkoorporimit dhe përfshirjes të elementeve CSS në dokumentet HTML.

Mënyrat e përfshirjes së kodeve CSS në një file **.html**

- Inline (në një rresh) duke përdorur atributin style brenda elementi HTML
- Internal (e brendshme) duke përdorur tagun `<style> </style>` në seksionin e head-it
- External (e jashtme) duke përdorur një file CSS të jashtëm

Mësuesi i fton nxënësit të hapin programin Notepad++ ose një editor online dhe të krijojnë strukturën e një dokumenti HTML. Për nxënësit, të cilët paraqesin veshitësi në krijimin e strukturës së dokumentit HTML, mësuesi i inkurajonë këta nxënës të ndjekin paralelisht punën që ai/ajo po shfaq në video-projektor.

Pasi nxënësit kanë krijuar strukturën e dokumentit, mësuesi i thotë nxënësve që në dokumentin e ruajtur (save) me prapashtesën **.html** të shtojnë disa elemente të njohura për ta siç mund të jenë: paragrafët, headings, imazhet, linqet etj...

Nxënësit ndahen në grupe dhe përcaktohen detyrat për secilin grup:

**Grupi I:** Të realizojë stilizimin e elementeve HTML duke përdorur stilizimin inline

**Grupi II:** Të realizojë stilizimin e elementeve HTML duke përdorur stilizimin internal

**Grupi III:** Të realizojë stilizimin e elementeve HTML duke përdorur stilizimin external, me ndihmën e një skedari të jashtëm të pavarur të ruajtur me prapashtësën .css

**Mësuesi përcakton formatin e stilizimit për secilin nga elementet HTML**

`<body> </body>` sfondi i background-it duhet të jetë ngjyrë kafe.

`<p> </p>` teksti i shkruajtur brenda paragrafit duhet të jetë i llojit "Helvetica" dhe me ngjyrë të bardhë.

`<h1> </h1>` teksti i shënuar brenda headings duhet të jetë i nënvizuar dhe me ngjyrë të verdhë.

`<img>` imazhet duhet të përmbajnë një kornizim 5 px me ngjyrë të zezë.

Ndërkohë që nxënësit punojnë në çifte për realizimin e kësaj detyre, mësuesi kalon nëpër kompjuterat e nxënësve për të parë ecurinë e punës, për të kontrolluar nivelin e përvetësimit të njohurive të marra, si dhe për të dhënë ndonjë ndihmë lidhur me pyetjet, paqartësitë apo vështirësitë që nxënësit hasin.

Pasi nxënësit kanë mbaruar me shkrimin e kodit, mësuesi fton para klasës një çift përfaqësuesish nga secili grup për të ekzekutuar kodin në kompjuterin e lidhur me video projektorin.

#### ▪ **Stilizimi inline**

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<title>Page Title</title>

</head>
<body style="background:brown;">
<h1 style="color:yellow; text-decoration: underline; ">Historia e Skënderbeut</h1>
<p style="color:white; font-family: Helvetica;">Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin e Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar - as para tij as pas tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.</p>

</body>
</html>
```

#### **Historia e Skënderbeut**

Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin e Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar - as para tij as pas tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.



## ▪ *Stilizimi internal*

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<title>Page Title</title>
<style>
body {
  background-color: brown;}
h1 {
  color: yellow;
  text-decoration: underline;}
p{
color:white; font-family: Helvetica;}
img
{border:5px solid black;
}
</style>
</head>
<body>
<h1>Historia e Skënderbeut</h1>
<p>Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin e Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar – as para tij as pas tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.</p>

</body>
</html>
```

### Historia e Skënderbeut

Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin e Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar – as para tij as pas tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.



## ▪ *Stilizimi external*

```
body {
  background-color: brown;}
h1 {
  color: yellow;
  text-decoration: underline;}
p{
color:white; font-family: Helvetica;}
img
{border:5px solid black;
}
```

File name:

Save as type:

### Historia e Skënderbeut

Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin e Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar – as para tij as pas tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.



Mësuesi fton nxënësit të japin komente lidhur me mënyrën më efektive të përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML, si dhe të japin një vlerësim lidhur me punën e realizuar nga grupet e tjera.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Për vlerësimin e nxënësve do të përdoren: përgjigjet me gojë, vëzhgime të drejtëpërdrejta gjatë punës në çift dhe individuale.

Nxënësi vlerësohet për:

- Identifikimin e tri mënyrave të përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML
- Stilizimin e elementeve HTML duke përdorur gjuhën CSS



- Aplikimin e njohurive të marra duke krijuar faqe të thjeshta html me elementë të ndryshëm stilizimi.
- Përdorimin e fjalorit informatik
- Bashkëpunimin përgjatë punës në grup

#### **Vlerësimi bazuar në nivelet e arritjeve:**

Niveli 2: Identifikon mënyrat e përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML

Niveli 3: Përdor disa prej mënyrave të përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML për të stilizuar elementë të thjeshtë që mund të përmbajë një faqe interneti.

Niveli 4: Vlerëson rëndësinë e përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML duke argumentuar rreth përzgjedhjes së mënyrave më efektive.

#### **Detyrat dhe puna e pavarur:**

Nxënësve i'u kërkohet të krijojnë një faqe web-i për një biznes lokal, ku të vendosen të gjithë elementet (taget) HTML të mësuara deri më tani dhe për elementë të ndryshëm të përdoren tri metodat e përfshirjes së kodit CSS. Detyra do të sillet e printuar dhe skedarët .html dhe .css të jenë të ruajtur në një USB për të parë ekzekutimin në klasë.

### **3.2.2 Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur**

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore;

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

#### **Orientime për zhvillimin e orës mësimore të hapur**

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur për kategorinë e parë të kualifikimit, më poshtë është dhënë një model ore mësimore.

*Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënësve, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.*

#### **A. Planifikimi i orës mësimore të hapur**

**A.1.** Mësuesi planifikon të gjithë **komponentët e orës së mësimimit** në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënësve:

- planifikon *rezultatet e të nxënit sipas programit lëndor;*
- planifikon *situatë të nxëni të cilën e përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies;*
- planifikon *organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënit;*
- planifikon *pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.*

**A.2.** Mësuesi planifikon temën mësimore me **qasje të reja inovative** që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore:

- planifikon *qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor;*
- planifikon *të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.*

## **B. Mjedi i të nxënit**

**B.1.** Mësuesi krijon një **klimë pozitive** dhe mjedis miqësor, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe:

- promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe;
- krijon një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.

**B.2.** Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes:

- *organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me **detyra motivuese** dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa.*
- *nxit nxënësit të **shprehin mendimet e tyre**, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.*

## **C. Metodatat mësimore**

**C.1.** Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave dhe stileve të të nxënit:

- *përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënit;*
- *përdor metoda e teknika duke i dhënë mundësi nxënësit të përmirësojnë arritjet e tij.*

**C.2.** Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin):

- *përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit;*
- *përdor metoda dhe teknika që nxisin diskutimin dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në veprimtari.*

**C.3.** Mësuesi formulon pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme duke nxitur nxënësit të bëjnë pyetje pergjatë orës së mësimit:

- *Mësuesi ndërton pyetje sipas niveleve;*
- *Nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit duke iu drejtuar dhe njëri – tjetrit.*

## **D. Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve**

**D.1.** Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij:

- *përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit;*
- *përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.*

**D.2.** Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes:

- *Përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.*

**D.3.** Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të nxënësve:

- *Angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të tyre.*

## **E. Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale**

**E.1.** Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore:

- *Krijon mjete mësimore didaktike në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore;*
- *Nxit te nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.*

**E.2.** Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve:

- *përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut;*
- *përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.*

**Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur**

<b>Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur</b>				
<b>Gjithsej 70 pikë</b>				
<b>Përshkruesit</b>	<b>Niveli 1 - Dobët</b>	<b>Niveli 2 – Mjaftueshëm</b>	<b>Niveli 3 – Mirë</b>	<b>Niveli 4 – Shumë mirë</b>
<b>Planifikimi i orës mësimore të hapur (10 pikë)</b>				
<b>Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënimit</b>	<b>0 – 1 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënimit (RN) nuk bazohen në programin lëndor dhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxënimit. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënimit. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.	<b>2 – 3 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënimit sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënimit, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënimit (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxënimit. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënimit, Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.	<b>4 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënimit sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënimit, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodot dhe teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënimit dhe me stilet e të nxënimit. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.	<b>5 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënimit sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënimit të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënimit, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.
<b>Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënimit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore</b>	<b>0 – 1 pikë</b> Mësuesi ka një planifikim ditor rutinë, pa u kujdesur për qasje të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënimit gjatë gjithë jetës.	<b>2 – 3 pikë</b> Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodot e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënimit gjatë gjithë jetës.	<b>4 pikë</b> Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodot e planifikuara fokusohen më së	<b>5 pikë</b> Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të

			shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.	përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.
<b>Mjedisi i të nxënit (14 pikë)</b>				
<b>Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.</b>	<b>0 – 1 pikë</b> <i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimit vetëm disa nxënës ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<b>2 – 3 pikë</b> <i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<b>4 - 5 pikë</b> <i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<b>6 - 7 pikë</b> <i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
<b>Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndër marrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</b>	<b>0 – 1 pikë</b> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimit.</i>	<b>2 – 3 pikë</b> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku jo gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndër marrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<b>4 - 5 pikë</b> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<b>6 - 7 pikë</b> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndër marrin iniciativa. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
<b>Metodat mësimore (21 pikë)</b>				
<b>Mësuesi organizon nxënësit në</b>	<b>0 – 1 pikë</b> <i>Mësuesi nuk organizon nxënësit</i>	<b>2 – 3 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që i</i>	<b>4 - 5 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që i njëj stilet e të</i>	<b>6 - 7 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që njëj shumë mirë</i>

<p><b>varësi të metodave që do të përdorë dhe stilet të të nxënësve të të nxënësve</b></p>	<p><i>në varësi të metodës së zgjedhur dhe demonstroi që nuk i njeh stilet e të nxënësve. Ora e mësimi është rutinë dhe kryesisht tradicionale.</i></p>	<p><i>njeh stilet e të nxënësve të tij por ora e mësimi është tradicionale pa u kujdesur që nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre bazuar në stilin e tyre të të nxënësve.</i></p>	<p><i>nxënësve të tij por metodat e teknikat që përdor në orën e mësimi nuk përfshijnë të gjitha stilet e të nxënësve duke krijuar kushte që jo të gjithë nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.</i></p>	<p><i>stilet e të nxënësve të tij dhe përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënësve duke i dhënë mundësi nxënësit të përmirësojnë arritjet e tij.</i></p>
<p><b>Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin).</b></p>	<p><b>0 – 1 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore mësuesi fokusohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i></p>	<p><b>2 – 3 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i></p>	<p><b>4 - 5 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxiti mendimin kritik, krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i></p>	<p><b>6 - 7 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshërinë e metodave të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i></p>
<p><b>Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxiti nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi.</b></p>	<p><b>0 – 1 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxiti nxënësit të bëjnë pyetje..</i></p>	<p><b>2 – 3 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxiti nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i></p>	<p><b>4 - 5 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxiti nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i></p>	<p><b>6 - 7 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxiti nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi dhe njëri – tjetrit.</i></p>

<b>Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)</b>				
<b>Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij.</b>	<b>0 – 1 pikë</b> <i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimi.</i>	<b>2 – 3 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimi.</i>	<b>4 - 5 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimi duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij.</i>	<b>6 - 7 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.</i>
<b>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes.</b>	<b>0 – 1 pikë</b> <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi por nuk përdor nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	<b>2 – 3 pikë</b> <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	<b>4 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	<b>5 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>
<b>Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të nxënësve</b>	<b>0 – 1 pikë</b> <i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënësit apo nevojat e nxënësve.</i>	<b>2 – 3 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi se njihet nevojat e nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<b>4 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi se njihet nevojat e nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i>	<b>5 pikë</b> <i>Mësuesi demonstroi se njihet nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të tyre.</i>
<b>Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)</b>				
<b>Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore</b>	<b>0 – 1 pikë</b> <i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e</i>	<b>2 pikë</b> <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat</i>	<b>3 pikë</b> <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në</i>	<b>4 pikë</b> <i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në</i>

	<i>rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	<i>përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë te nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
<b>Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve</b>	<b>0 – 1 pikë</b> <i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore,</i>	<b>2 pikë</b> <i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por përmbajtja nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënit të temës mësimore.</i>	<b>3 pikë</b> <i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK.</i>	<b>4 pikë</b> <i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>